

Vendim nr. 213, datë 25.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 25.06.2026 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 6 (B) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **BLEDAR HAROKU**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 2797, datë 24.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2101 (30-2023-7505), datë 13.12.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-1512, datë 14.10.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatore n e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në muajin shtator të vitit 2013 kërkuesi dhe shtetasi D.S., me ndërmjetësimin e shtetasit J.D., kanë zhvilluar një takim me shtetasin N.Sh., në hotelin e tij në Durrës, me qëllim daljen e këtij të fundit garant për marrjen e një huaje prej 100.000 eurosh nga shtetasi L.V. Ndonëse fillimisht shtetasi N.Sh. ka refuzuar, me këmbënguljen e kërkuetit dhe të ndërmjetësuesit J.D. ka pranuar, duke kontaktuar huadhënësin L.V., i cili u ka dhënë shumën e kërkuar, duke marrë si garanci për shlyerjen e huas shtëpinë e palegalizuar të nënës së kërkuetit (*shtetasja L.H.*). Në datën 21.08.2013, pranë një zyre noteriale në Tiranë, është nënshkruar akti përkatës, i cili, sipas shtetasit N.Sh. (*garanti i huas*), nuk ishte lexuar prej tij, duke menduar se ishte përpiluar sipas bisedës së bërë mes tyre.

2. Në vijim, kërkuesi, shtetasi D.S., dhe ndërmjetësuesi J.D., i kanë kërkuar ndihmë garantit të huas N.Sh. për të siguruar një licencë tregtimi hidrokarburesh në emër të shoqërisë “X” sh.a., Në vijim, garanti i huas, N.Sh., kërkuesi dhe shtetasi D.S., kanë udhëtuar jashtë vendit, për qëllime biznesi dhe të gjitha shpenzimet e këtyre udhëtimeve (6.000 euro dhe 10.000 euro), janë përballuar nga garanti i huas N.Sh., sikurse pretendon ky i fundit. Në muajin dhjetor 2013 kërkuesi dhe shtetasi D.S. i kanë kërkuar garantit të huas së parë, N.Sh., një tjetër shumë prej 100.000 dollarësh, për një biznes me një tregtar naftë në Gjermani. Me ndërmjetësimin e garantit të huas së parë, N.Sh., huadhënësi i huas së parë, L.V., ka dhënë sërish shumën e kërkuar në formë huaje, nga e cila 28.000 euro janë marrë menjëherë nga kërkuesi për të shlyer shtetasin I.Z., ndërsa më pas kërkuesi i ka kërkuar edhe 25.000 euro të tjera për blerjen e një autoveture “Audi”, duke premtuar se në rast të mosshlyerjes së huas do t’i linte automjetin si garanci.

3. Pas dorëzimit të shumës së dytë nga garanti i huas N.Sh., në janar 2014, ky i fundit ka udhëtuar sërish me kërkuetin, shtetasin D.S., dhe persona të tjerë drejt Gjermanisë, duke qëndruar në disa shtete, për takime të pretenduara biznesi në fushën e naftës. Të gjitha shpenzimet e udhëtimeve, në shumën rreth 100.000 euro, janë përballuar nga garanti i të dyja huave, N.Sh., sikurse ka pretenduar ai. Ndërkohë, pasi është kthyer në Shqipëri, garanti i dy huave, N.Sh., ka

tentuar disa herë të kontaktojë me kërkuesin dhe shtetasin D.S. për kthimin e huave, por pa rezultat. Në ditët në vijim, garanti i huave, N.Sh., ka konstatuar se kërkuesi ndodhej në Shqipëri dhe ia kishte dhënë automjetin “Audi” shtetases E.M. kundrejt shumës prej 3.000.000 lekësh.

4. Ndodhur në këto kushte dhe pasi ka konstatuar se akti noterial që kishte firmosur pa e lexuar, pasqyronte një shumë të ndryshme nga ajo reale (nga 100.000 euro në 50.000 euro), garanti i huave N.Sh. ka paraqitur kallëzim penal kundër kërkuesit dhe shtetasit D.S., mbi të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*) ka regjistruar procedimin penal nr.3681 të vitit 2014 për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i dytë, i Kodit Penal (KP). Gjithashtu, mbi bazën e kallëzimit penal të ndërmjetësuesit J.D., Prokuroria e Tiranës ka regjistruar procedimin penal nr.4892 të vitit 2014, për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i dytë, i KP-së në ngarkim të kërkuesit dhe shtetasit D.S. Në kushtet kur të dyja procedimet penale janë regjistruar në ngarkim të të njëjtëve persona të kallëzuar, është bërë bashkimi i tyre në procedimin penal nr.3681 të vitit 2014. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Tiranës ka akuzuar kërkuesin për veprën penale “Mashtrimi”, të kryer në bashkëpunim, me shtetasin D.S., të parashikuar nga neni 143, paragrafi i dytë, i KP-së.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1299, datë 22.04.2015, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i dytë, i KP-së dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim. Mbi ankimin e përfaqësuesit ligjor të kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1840, datë 30.10.2015, ka vendosur mospranim të ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

6. Me shkresën e datës 07.06.2021, Zyra Qendrore Kombëtare e Interpol Tirana ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme shqiptare se në datën 05.06.2021 është arrestuar në Suedi për arsye ekstradimi në Shqipëri kërkuesi, i dënuar me vendim të formës së prerë. Me shkresën e datës 14.06.2021, Prokuroria e Përgjithshme i ka kërkuar Ministrisë së Drejtësisë ekstradimin e kërkuesit nga Suedia, duke i dërguar dokumentacionin përkatës. Fillimisht, autoritetet suedeze kanë refuzuar ekstradimin, me arsyetimin se kërkuesi është gjykuar në mungesë dhe kanë kërkuar garanci nga shteti shqiptar për garantimin e së drejtës për një shqyrtim të ri gjyqësor ku kërkuesit t’i sigurohet e drejta e mbrojtjes. Pas marrjes së garancisë për rigjykimin e kërkuesit me shkresën e datës 05.08.2021, të Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, me vendimin e datës 17.12.2021, Gjykata e Lartë e Suedisë ka vendosur lejimin e ekstradimit.

7. Mbi kërkesën e kërkuessit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.424, datë 20.04.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë nr. 1299, datë 22.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rrëzimin e kërkesës për pezullim të tij dhe dërgimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuessit po në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Në rigjykim, kërkuessi nuk u paraqit në gjykim me vullnetin e tij duke u përfaqësuar nga një avokat mbrojtës, i zgjedhur prej tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi analizoi aktet e fashikullit gjyqësor dhe konstatoi se kërkuessi është gjykuar në mungesë me avokat të caktuar kryesisht nga gjykata dhe nuk ka pasur dijeni për çështjen penale në ngarkim të tij, ka pranuar kërkesën e kërkuessit për gjykim të shkurtuar.

8. Në procesin e rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2797, datë 24.11.2022, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuessit, për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i tretë, i KP-së dhe dënimin e tij me pesë vjet burgim, uljen e dënimit me një të tretën, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe dënimin e tij me tre vjet e katër muaj burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuessi, nëpërmjet avokatit të tij, duke pretenduar se nuk është provuar fajësia e tij.

9. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 2101 (30-2023-7505), datë 13.12.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuessi.

10. Me vendimin nr. 00-2025-1512, datë 14.10.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuessit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

11. Në datën 15.04.2026 kërkuessi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 30.04.2026.

II

Pretendimet e kërkuessit

12. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor* në drejtim të *standardit të arsytimit të vendimit* gjyqësor, pasi gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë analizuar provat shkresore në dosjen gjyqësore për marrëdhëniet ndërmjet kallëzuesve dhe kërkuessit, kontratat e lidhura mes palëve, ku janë përcaktuar edhe fitimet e tyre, burimin e të ardhurave të huadhënësit, procedurën përmbartimore të administruar në dosjen gjyqësore që vërteton se marrëdhënia është juridiko-civile dhe jopenale,

procedurën e ekstradimit lidhur me garancitë e dhëna nga shteti shqiptar për lejimin e ekstradimit të kërkuarit, mungesën e një sërë veprimesh hetimore nga ana e Prokurorisë si hetim pranë “Raiffeisen Bank” në llogarinë e shoqërisë “X” sh.a., transkriptimin e CD-së, ku janë regjistruar takimet e biznesit mes palëve, ekspertimin kontabël të shpenzimeve të kryera nga shoqëria “X” sh.a., blerjen e një toke bujqësore prej 9000 m², për të cilën është kërkuar huaja, pasqyrat e llogarisë së shoqërisë “X” sh.a. nga ku janë kryer shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, komunikimet telefonike për të vërtetuar se ishin jashtë vendit në të njëjtën kohë, faturat e drekave e të darkave të shpenzuara nga kallëzuesi N.Sh., si dhe kontratat e furnizimit me karburant dhe të marrjes me qira të depozitave të karburantit nga shoqëria “X” sh.a., të cilat vërtetojnë se kjo e fundit ka pasur aktivitet. Sipas kërkuarit, mosmarrëveshja është civile, që ligjërisht mund dhe duhet të zgjidhet me padi civile, pasi dëmi i pretenduar nga kallëzuesit është shkaktuar në kushtet e një marrëdhënieje biznesi dhe huaje mes tyre. Gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale sipas nenit 143, paragrafi i tretë, të KP-së, ndërkohë që Prokuroria e Tiranës nuk e ka kontestuar cilësimin juridik sipas nenit 143, paragrafi i dytë të po këtij kodi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

13. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*), në kuptimin e aftësisë për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues individual, është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe kriteret e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kërkuari, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në

lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 14.10.2025 dhe është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 18.12.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 15.04.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës.

15. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi gjykatat e faktit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë analizuar provat shkresore në dosjen gjyqësore, nuk janë shprehur për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, si dhe mosmarrëveshja duhet të zgjidhet me padi civile në kushtet e një marrëdhënieje biznesi dhe huaje mes palëve (*shih paragrafin 12 të pretendimet e kërkuesit*)

16. Për sa i përket standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, pasi u tregon palëve se ato janë dëgjuar dhe u jep mundësinë ta kundërshtojnë atë. Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje, ndërsa argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara, të lidhura logjikisht dhe të mjaftueshme për të mbështetur pjesën urdhëruese. (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 63, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka theksuar se detyrimi për arsyetimin e vendimit gjyqësor nuk nënkupton se gjykata duhet t’i japë përgjigje të detajuar çdo pretendimi të palëve, pasi shtrirja e këtij detyrimi varet nga natyra e vendimit dhe rrethanat e çështjes konkrete (*shih vendimet nr. 1, datë 17.01.2025; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 38, datë 12.07.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me vendimet e mospranimit të rekursit, Gjykata ka pranuar se arsyetimi i Gjykatës së Lartë mund të jetë i kufizuar, për sa kohë vendimi pasqyron shkaqet e rekursit dhe shpreh, në thelb, arsyet e mospranimit të tij. (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 45, datë 03.07.2017; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata ka theksuar gjithashtu se vlerësimi i fakteve dhe i provave të administruara, si dhe interpretimi i ligjit janë detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës

është të shqyrtojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që bie ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e zakonshme është aq i dukshëm sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë, ose kur ai është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 23.10.2025; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Mbi këto standarde, Kolegji do të vlerësojë në vijim nëse gjykatat e faktit kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për bazën provuese mbi të cilën është mbështetur deklarimi fajtor i kërkuesit dhe për arritjen e standardit të fajësisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm, pa zëvendësuar vlerësimin e tyre mbi faktet dhe provat. Po kështu, do të vlerësohet nëse Gjykata e Lartë, në fazën e shqyrtimit paraprak të rekursit, ka dhënë përgjigje të mjaftueshme ndaj shkaqeve thelbësore të rekursit që lidheshin me këto pretendime, në mënyrë që e drejta e kërkuesit për arsyetimin e vendimit gjyqësor të mos mbetet thjesht formale.

19. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, Kolegji vëren se kërkuesi është hetuar për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i dytë, i KP-së, mbi bazën e dy kallëzimeve penale të bashkuara më pas në procedimin penal nr.3681 të vitit 2014. Në përfundim të gjykimit të zakonshëm, gjykata e shkallës së parë, në mungesë të kërkuesit, e ka deklaruar atë fajtor për veprën penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i dytë, i KP-së dhe e ka dënuar me 15 vjet burgim, vendim i lënë në fuqi edhe nga gjykata e apelit. Pas ekstradimit të tij nga Suedia, kërkuesi ka kërkuar rigjykim të çështjes (*shih paragrafin 7 të rrethanat e çështjes*).

20. Në përfundim të procesit të rigjykimit, gjykata e shkallës së parë ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit, për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i tretë, i KP-së dhe dënimin e tij me pesë vjet burgim, uljen e dënimit me një të tretën, në zbatim të nenit 406 të KPP-së, dhe dënimin e tij me tre vjet e katër muaj burgim. Lidhur me faktin penal, ajo gjykatë ka vlerësuar në cilësinë e provës: (i) deklaramet e kallëzuesve për marrjen e shumave me mashtrim nga kërkuesi nëpërmjet shpërdorimit të besimit dhe të gënjeshtërs, me qëllimin për të mos i kthyer më; (ii) hetimin e kryer nga prokuroria në drejtim të përdorimit të shumës së marrë për shlyerjen e detyrimi prej 28.000 eurosh për një automjet të blerë më parë si dhe tërheqjen për nevojat e tyre të shumës prej 36.500 eurosh të depozituar nga njëri prej kallëzuesve në llogarinë e shoqërisë së kërkuesit dhe të bashkëpunëtorit të tij; (iii) hetimin e

kryer në llogaritë e shoqërisë së kërkuesit dhe të bashkëpunëtorit të tij nga ku ka rezultuar se ajo nuk ka pasur në asnjë moment aktivitet tregtar efektiv, duke mos deklaruar asgjë, si Tatimfitimi, TVSH-ja etj.; (iv) këqyrjen e bisedave të kryera midis kallëzuesit dhe kërkuesit të administruara në fashikullin hetimor, nga ku është provuar marrja e parave dhe mbajtja me premtime se aktiviteti do të funksiononte dhe se do t'u ktheheshin paratë sa më parë, derisa të dy të pandehurit janë larguar jashtë shtetit, pa asnjë adresë, duke mos komunikuar me kallëzuesit. Në përfundim, bazuar në provat e marra në gjykim, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se veprimet e kërkuesit dhe të bashkëpunëtorit të tij plotësojnë të gjitha elementet për t'i cilësuar këto veprime si elemente të figurës së veprës penale “Mashtrimi” me pasoja të rënda, të kryer në dëm të viktimave, të parashikuar nga neni 143, paragrafi i tretë, i KP-së, i ndryshuar, por duke mbajtur parasysh në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit rrezikshmërinë e vogël të kërkuesit, i cili ka rezultuar i padënuar më parë, si dhe faktin se ai ka dy fëmijë të mitur në ngarkim.

21. Çështja në vijim, mbi ankimin e kërkuesit, është shqyrtuar nga gjykata e apelit, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se, duke i vlerësuar provat në harmoni me njëra-tjetrën dhe në analizë të tërësisë së akteve në gjykim, akuza në ngarkim të kërkuesit për të cilën është gjetur fajtor nga gjykata e shkallës së parë, është provuar plotësisht me të gjithë elementet e saj, tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas gjykatës së apelit, gjatë gjykimit është provuar se vepra penale është kryer nga kërkuesi në bashkëpunim me të pandehurin tjetër, me veprime aktive të kundërligjshme, nëpërmjet paraqitjes së fakteve të rreme ose duke fshehur fakte të vërteta, me anë të gënjeshtres e njëkohësisht shpërdorimit të besimit, duke u vjedhur viktimave shumat e lekëve, duke shfrytëzuar njohjen shoqërore, duke paraqitur të dhëna të rreme e fshehur fakte të vërteta, si dhe duke përvetësuar shumën e lekëve. Sipas gjykatës së apelit, ka rezultuar e provuar vërtetësia e ngjarjes dhe dinamika e kryerjes së veprës penale nga kërkuesi referuar dëshmimeve të marra e të analizuara në përputhje me provat e tjera shkresore, informacionit të marrë nga Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Qendra Kombëtare e Licencimit për datën e regjistrimit dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë së kërkuesit dhe të bashkëpunëtorit të tij, si dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë nga ku ka rezultuar se nuk ka pasur në asnjë moment aktivitet tregtar efektiv, informacionit të marrë nga bankat e nivelit të dytë sipas të cilit shoqëria e kërkuesit dhe e bashkëpunëtorit të tij nuk ka më asnjë shumë të depozituar në llogari, pasi janë tërhequr duke lënë llogaritë bosh ose me shuma të papërfillshme. Sipas gjykatës së apelit, kërkuesi nuk ka vepruar në mirëbesim dhe marrëdhënia nuk ka natyrë juridiko- civile.

22. Ndërkohë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka shqyrtuar rekursin e kërkuarit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kërkuari nuk ka argumentuar ndonjë shkelje të ligjit material ose procedural penal nga gjykatat e faktit, të cilat kanë parashtruar në mënyrë të përmbledhur rrethanat e faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe kanë dhënë arsyet për të cilat gjykatat i kanë quajtur të papranueshme pretendimet e kërkuarit të parashtruara në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, duke e argumentuar vendimmarrjen bazuar në standardin “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

23. Për sa më lart, Kolegji vëren se vendimet e kundërshtuara përmbajnë arsyet mbi të cilat gjykatat e zakonshme kanë mbështetur përfundimet e tyre për faktin penal dhe fajësinë e kërkuarit. Nga arsyetimi i këtyre vendimeve nuk rezulton që gjykatat ta kenë paraqitur përgjegjësinë penale të kërkuarit thjesht mbi bazën e aludimeve ose dyshimeve, por se ato kanë identifikuar rrethanat që, sipas tyre, përcaktonin faktin penal të vjedhjes së shumave të lekëve nëpërmjet mashtrimit, motivin e kryerjes së veprës penale, lidhjen e kërkuarit me ngjarjen, si dhe provat e shqyrtuara në një proces kontradiktor dhe të vlerësuara në tërësi e në harmoni me njëra-tjetrën, ku mbështetej përfundimi për fajësinë e kërkuarit, i cili nuk rezulton të jetë bërë pa një shqyrtim të plotë të çështjes ose pa arsyetuar arritjen e standardit të fajësisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nga vendimet e kundërshtuara nuk rezulton që kërkuarit t'i jetë mohuar mundësia për të kundërshtuar provat e akuzës për të paraqitur prova ose për të parashtruar versionin e tij mbrojtës.

24. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë, Kolegji vëren se, ndonëse kërkuari pretendon se ajo nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuara shkaqeve të rekursit, nga përmbajtja e vendimit rezulton se Gjykata e Lartë ka evidentuar dhe trajtuar pretendimet kryesore të tij, përfshirë ato për standardin e arsyetimit, përdorimin dhe vlerësimin e provave, si dhe të trajtimit të çështjes në aspektin civil e jopenal. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat kanë analizuar provat si në aspektin faktik (provueshmërisë), të mbështetur në analizën e tyre, ashtu edhe cilësimin juridik të veprës sipas nenit 143, paragrafi 3, të KP-së, duke krijuar bindjen e saj për fajësinë e kërkuarit dhe se shkaqet e ngritura në rekurs nuk përbëjnë shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Në këtë kuptim, edhe pse arsyetimi i saj është i kufizuar, ai shpreh në mënyrë të dallueshme arsyet e mospranimit të rekursit, brenda funksionit të Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji.

25. Nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuari nuk ka arritur të tregojë se Gjykata e Lartë i ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, për shkak të mungesës së përgjigjes

së arsyetuar ndaj shkaqeve të rekursit. Gjithashtu, vendimet gjyqësore të kundërshtuara, të lexuara në tërësinë e tyre, nuk rezultojnë të paarsyetuara në atë masë që të cenojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

26. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.